



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 28 janar 2019.
2. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit.
3. Seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH.
4. Votimi dhe miratimi i 3 kandidaturave për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Anduel Xhindi(zëvendësues) dhe Sadi Vorpsi(zëvendësues).

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Kemi kuorumin e nevojshëm, prandaj mund të procedojmë.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 28 janar 2019. Me ndryshime, sepse na e ke dërguar dy here?

Sekretarja e Komisionit – Jo, e kontrollova unë, sepse rregullova disa gjëra.

Albana Vokshi – Jeni dakord me procesverbalin? E keni parë?

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit. Në orën 13:00 kemi një seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e tri vendeve vakante në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Janë tri vende vakante. Kemi edhe emrat e kandidatëve.

Për kalendarin, jemi ende në mes të diskutimit të amendamenteve që janë propozuar nga LSI-ja për ligjin e arsimit të lartë.

Kush ka propozime për kalendarin e kësaj jave apo të javës tjetër?

Ke ndonjë ide, Vali?

Kejdi Mehmetaj - Meqenëse e kemi diskutuar edhe kur bëmë mbledhjen javën që kaloi, për kalendarin ramë parimisht dakord që do të thërrasim në dëgjësë edhe një grup studentësh përfaqësues, le të themi, ata që janë si më të zgjedhurit, për të diskutuar qoftë për amendimet, qoftë për problematikën në përgjithësi, si dhe me pedagogët.

Unë sugjeroj që, meqenëse të mërkurën e kemi të zënë me ministrin Lleshaj, nesër të zhvillojmë dëgjësën me studentët, në qoftë se do të biem të gjithë dakord.

Albana Vokshi - Vali dhe më pas Luçi.

Valentina Duka – Nuk e di nëse realizohet nesër apo jo, por mendoj që në dëgjësë të thërrasim përfaqësues të seneve të universiteteve ose, ndoshta, edhe rektorë të universiteteve, për të na thënë se si e kanë perceptuar ata lëvizjen studentore, plotësimin e 8 kërkesave të studentëve, por edhe problematikën që kanë lindur gjatë rrugës, përplasjet me Kryeministrin e të tjerë.

Luçiano Boçi – Kryetare, meqenëse sot po bëhet mbledhja e asamblesë për të vendosur qëndrimin e saj në raport me kërkesat që i janë paraqitur ministrisë, kemi rastin që në seancën më të afërt fillimisht t'i thërrasim ata në dëgjese dhe më pas të vijojmë me studentët.

Mbështes Valin për thirrjen e rektorëve. Është shumë e domosdoshme që rektorët të shprehen për ndryshimet që janë propozuar, sepse prekin direkt organizimin e institucionit të tyre, aq më tepër kur sot po diskutohet një çështje e rëndësishme në universitete, që nuk ka dalë në sipërfaqe në medie, që përgjysmimi i *bachelor*-it, siç është trumbetuar, godet në tërësi buxhetet e universiteteve.

Qeveria thotë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, janë duke falimentuar. Qeveria gënjen kur thotë se kanë fonde, ndërkohë që i ka përgjysmuar fondet e universiteteve. Sot, Universiteti i Tiranës, i Vlorës, i Elbasanit, i Shkodrës, janë pa fonde. Janë duke falimentuar dhe në pamundësi për t'u dhënë paga pedagogëve. Deri sot që po flasim pagat e pedagogëve nuk kanë kaluar. Kjo është pjesë e falimentimit të universiteteve.

Albana Vokshi – Po, Milva.

Milva Ekonomi – Sugjeroj që në zbatim të Rregullores të ndajmë dy momente.

Nëse duam të thërrasim në dëgjese pedagogët, studentët, rektorët apo ata që ne do të biem dakord për t'i thirrur për ligjin, duhet të kalojmë te miratimi në parim i projektligjit, sepse kjo është një kërkesë e Rregullores. Në qoftë se duam të bëjmë dëgjese me këto grupe për të cilat po flasim, duhet t'i shikojmë të përjashtuar nga dëgjesa për ligjin, sepse ne kemi miratuar një Rregullore. Aktet dhe veprimet që ndërmarrim si komision për propozimin për ndryshime në ligj janë të paracaktuara. Kështu që, ose do të kalojmë te miratimi në parim i ligjit dhe më pas do të bëjmë dëgjesat, ose do të vendosim të bëjmë dëgjesat, duke mbaruar... Nuk ka lidhje me këtë propozim. Kështu që duhet ta pleqërojmë pak këtë, se si do ta organizojmë.

Albana Vokshi – Pjesë e diskutimit në parim ishte edhe pjesëmarrja e ministres, e cila do të jepte informacionin e duhur, do t'u përgjigjej pyetjeve të deputetëve, por, sikurse e dini, ministrja, në mënyrë arrogante vendosi, në mes të fjalës së kryetares së komisionit, të largohej. Madje, komunikimi me ministren ishte në një formë krejt joetike, të papranueshme për një anëtare kabineti.

Jam shumë dakord që të ndjekim Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, jam shumë dakord, sepse, në fund të fundit, atë kemi si statut të komisionit.

Janë dëgjesa që do t'i shërbejnë edhe vendimit të komisionit për amendimet që ka bërë LSI-ja.

Meqenëse kemi një ngjarje, që po ndodh aktualisht në ambientet e Qytetit Studenti, jam dakord me atë që thotë Luçi. Ne kemi mundësi t'i dëgjojmë studentët, sepse kjo është një çështje... Nëse shpallet grevë, unë nuk e di vendimin e asambleve, mendoj se reagimi i komisionit përgjegjës për arsimin duhet të jetë i menjëhershëm, sepse në 28 vjet e kusur nuk ka pasur një ngjarje kaq të rëndësishme për arsimin e lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër.

Vetëm se duhet ta përmbledhim, sepse në orën 13:00 do të fillojmë dëgjesat.

Nora Malaj – Është shumë e drejtë ajo që thoni ju, në të dyja rastet, në rastin e zbatimit të Rregullores dhe në situatën aktuale.

Po të lexojmë vendimet që kanë dalë, Fakulteti i Shkencave Sociale ka shpallur grevën, pra nuk ka pritur vendimmarrjen e asamblesë. Kjo do të thotë se jemi përpara një situatë, qoftë edhe sikur të jetë vetëm një fakultet, të jashtëzakonshme. Pra, kemi një situatë me një ngarkesë... Mendoj se gjithmonë prevalon situata më e rëndësishme sesa periudha për të trajtuar vendimmarrjen. Besoj se kjo mund të bëjë ndarjen dhe menaxhimin e situatës.

Luçiano Boçi – Meqenëse seancën e kaluar patëm dëgjesë me ministren dhe një nga pretendimet justifikuese të ministres për braktisjen e dëgjesës ishte se do t'i dërgonte përgjigjet me shkrim, si anëtar i komisionit, koha ka qenë e disponueshme për ministren, kërkoj që sot të kemi përgjigjet me shkrim të ministres për pyetjet që kemi parashtruar. Përndryshe, ministrja të vijë përsëri, në varësi të kërkesës sonë, në seancë dëgjimore, sepse “do jua sjell” dhe i lë pa përgjigje, më duket arrogancë mbi arrogancën. Kjo nuk mund të jetë e pranueshme, as nga opozita, por besoj se as nga maxhoranca.

Albana Vokshi – Pyetjet nuk u bënë të gjitha. Unë vetëm një pyetje arrita të bëj, sepse ju e patë vetë që ministrja u largua në mënyrë arrogante, joetike, të papërshtatshme, fyese dhe poshtëruese ndaj institucionit më të lartë të një shteti.

Ministrja e ka për detyrë të vijë në një dëgjesë. Besoj se këtu biem dakord të gjithë që ministrja duhet të vijë në një dëgjesë, por duhet të fokusohemi tek ajo çfarë ju sugjeroni, që ta nisim nesër.

Të mërkurën e kemi ditën të zënë, sepse kemi ministrin e Brendshëm, për arsyen e dhunës që është ushtruar brenda ambienteve universitare, me kërkesë të 8 deputetëve të opozitës.

Nëse doni, shfrytëzojmë edhe të premtën, në varësi të propozimeve dhe sugjerimeve që keni sot. Pastaj kemi të hënën, të martën dhe të mërkurën e javës tjetër.

Po, Shezai.

Shezai Rrokaj -Ta bëjmë pak më konkrete. Ministria tha se nuk ishte e detyruar të përgjigjej për pyetje që dilnin jashtë agjendës së saj dhe pyetjeve që ne i kishim drejtuar. Mund ta mirëkuptoj ministren.

Bashkohem me këtë propozim. Javës që vjen të parashikohet, kur ta ketë mundësinë ministria, një dëgjese ku ajo t'u përgjigjet jo vetëm pyetjeve që u shtruan atë ditë, por të gjithë deputetë e pranishëm këtu të hartojnë pyetje, që t'i drejtohen zyrtarisht, në mënyrë që të kemi përgjigje më të menduara. Do të ishte normale për këdo. Është edhe ministre e re. Mendoj se është më mirë që të bëhen pyetje, përveç atyre të drejtuara më parë, sepse bashkohem me shqetësimin e Luçianos.

Unë dhe Valentina kemi drejtuar dekanate. Ndoshta mund të ketë edhe ndonjë tjetër që ka drejtuar dhe unë mund të mos e di. Për këtë kërkoj ndjesë.

Ka një problem. Ne që drejtojmë, e dimë se të ardhurat e fakulteteve nga tarifat grumbulloheshin deri në fund të janarit. Përgjithësisht, me këto të ardhura, fakultetet mbulojnë shpenzimet operative, që nga uji, energjia, kancelaritë, ekspeditat, lëndët për laboratorët... I përdorin për pagesat e orëve të pedagogëve të jashtëm dhe për mbingarkesat e pedagogëve të brendshëm, për investimet, si dhe dy muaj paga, të paktën këtu i referohem Universitetit të Tiranës. Pra, boshllëku që është krijuar në arkën e universitetit, për shkak të kësaj që ndodhi, duhet të marrë seriozitetin e duhur, sepse nga muaji mars, unë e kam thënë publikisht këtë gjë, universitetet futen në krizë financiare, nëse nuk do të kompensohet diferenca nga politikat e VKM-ve, e qeverisë, për përgjysmim dhe trajtim.

Po ju them edhe një gjë tjetër: kategoritë në nevojë, për ata që nuk e dinë, nuk janë paguar asnjëherë nga qeveritë, të paktën në këto vite. Pra, nuk janë subvencionuar universitetet, se është e zezë mbi të bardhë kjo. Qeveritë gjithmonë kanë bërë politika sociale, por nuk i kanë kompensuar universitetet. Kanë lënë që të kjo të përballohej te fondet e kushtëzuara, të paguara nga studentët.

Ka një problematikë, që është shumë urgjente dhe ne duhet të bëjmë presionin e duhur, në mënyrë që paratë të shkojnë atje dhe universitetet të mos e ndiejnë këtë. Deri tani, nuk jam në dijeni që paratë kanë shkuar. Nuk e di nëse kanë shkuar sot, nuk kam informacion. Kjo gjë duhet bërë për të mirën e funksionimit të universiteteve. Prandaj, thirrja e ministres, edhe për këtë...

Mund të bëjmë shumë filozofi dhe debate politike, por kjo është ekzistenciale për funksionimin e universiteteve, po të më dëgjoni mua.

Romeo Gurakuqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të tërheq vëmendjen për disa probleme, që lidhen me situatën e krizës që po kalojmë, si dhe përgjegjësinë që ka ky komision i nderura.

T’ju them se gjendja në universitete është e rënduar, këtë e di gjithsecili prej nesh. Është një pasqyrë krejt e qartë e krizës që po kalojmë. Kam vënë re gjatë gjithë kësaj periudhe përpjekjen për ta zgjidhur krizën shumë të rëndë, 2 muaj pa mësim, përmes arnimeve, ndërkohë që problemi është strukturor. Kemi të bëjmë me një defekt strukturor, me një keqlllogaritje, jo në strategji, por, para së gjithash, në shkrimin e legjislacionit, që ka dhënë të gjitha rezultatet e tjera.

Problemi është: a është konceptuar qeverisja si një shërbim ndaj publikut? Sipas këndvështrimit tim, duke qenë se studentët kanë 2 muaj që janë në revoltë dhe çdo ditë që kalon është orë mësimi, është pikë kreditesh që nuk realizohen, me arnimet, qoftë politike, qoftë në Ministrinë e Arsimit apo edhe në ligj, që po tentohet të bëhen, unë e kam parë me vëmendje atë lloj arnimi të propozimit, nuk shoh ndonjë perspektivë. Ne duhet ta ndajmë mendjen: kemi ardhur për t’i shërbyer publikut dhe për të bërë një zgjidhje strukturore, ne jemi pedagogë dhe e dimë thelbin e problemit, apo kemi ardhur për të bërë një arnim të radhës, për t’u sjellë rrumbullak brenda krizës dhe përgjegjësit e krizës të vazhdojnë të jenë në të njëjtat pozita, sikurse është krijuar rrethana. Sipas meje, kemi ardhur në një moment përtej të cilit nuk mund të lejojmë më asnjë vonesë në universite, orë leksionesh të pazhvilluara, orë punësh të pavarura, orë pune në bibliotekë të pazhvilluara prej dy muajsh, të gjitha këto përbëjnë një kohë 2 muaj shtyrjeje të domosdoshme të afatit të studimeve, domethënë është një cikël i caktuar, i cili nuk zhvillohet.

Të gjitha këto mungojnë dhe në çdo vend demokratik një komision i ngjashëm si yni nuk do ta kalonte situatën në një formë të tillë, jo vetëm në aspektin e zgjidhjes së krizës së sistemit universitar shqiptar, por, pak më tutje, në zgjidhjen në mënyrë të përgjegjshme të krizës politike që ka mbërthyer vendin. Nuk e kam konceptuar asnjëherë atë që po ndodh në sistemin universitar shqiptar si një gjë të veçantë nga e gjithë kriza strukturore që ka përfshirë vendin dhe që kërkojmë ta tejkalojmë me një arnim të radhës, pa e parë efektin thelbësor aty ku është.

Sipas këndvështrimit tim, e gjithë qasja që është ndjekur është kundër *common sense*-it, domethënë arsyes së shëndoshë, dhe, si maxhorancë e kam fjalën, e keni ndërtuar të gjithë sistemin e reformave të bazuar jo në logjikën e reformimit, por në interesa parciais, të cilat nuk shkojnë për publikun, por shkojnë për interesat e mbisundimit të maxhorancës.

Sa i përket zgjidhjes së krizës së mirëfilltë në universitete, nuk kam ardhur për t'ju dhënë ndonjë recetë. Fjala ime konsiston para së gjithash në tërheqjen e vëmendjes, duke pasur parasysh që të gjithë jemi mësues, një pjesë prej jush e vlerësojnë njësoj si unë analizën e sistemit dhe ka ardhur momenti që ndërgjegjja e gjithsecilit prej nesh të reflektojë për t'i dhënë një zgjidhje tërësore. Problemi është a duhet t'i japim një zgjidhje tërësore që do t'i shërbejë të ardhmes së universiteteve tona, apo do të bëjmë makijazhin e radhës dhe do ta lëmë situatën aty ku ndodhet? Ky është problemi që duhet të zgjidhim dhe do të duhet ta trajtojmë me shumë vëmendje, jo thjesht me disa dëgjesa, por me një ndërhyrje thelbësore në zgjidhjen e krizës politike që ka mbërthyer vendin, pas kësaj edhe të krizës së sistemit universitar shqiptar.

Ju faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Milva Ekonomi – Më falni, doja të përsërisja diçka: ju keni të drejtë që mendoni se duhet të bëjmë dëgjuesën me ministren dhe të gjithë anëtarët, po ndërkohë dua t'ju sjell edhe një herë në vëmendje se duhet të bëjmë dëgjuesat jo vetëm në kuadrin e ndryshimit ose propozimeve për amendime që i bëjmë projektligjit. Ta lëmë mënjane këtë proces dhe të bëjmë dëgjesa për arsye të problemeve që nuk i vëmë re, të situatës. Kështu që dua ta kemi të gjithë të qartë këtë.

Nora Malaj – Besoj e keni dëgjuar të gjithë lajmin e këtyre dy ditëve, bëhet fjalë për rastin e vajzës nga Kavaja, që mendoj se është shumë shqetësues dhe stresues. Ndërkohë që nga viti 2015-2016, dy ministritë, ajo e Arsimit dhe e Brendshme, kanë lidhur një marrëveshje në kuadër të policimit të fëmijëve e të tjera. Është në nderin tonë që t'i thërrasim të dy ministrat për t'i dëgjuar rreth ngjarjes, për ta bërë rastin më transparent dhe për të parë si dhe çfarë mund të bëhet. Ndaj dua t'ju bëj thirrje në emër të situatës së bulizmit, i cili me të vërtetë është problematik, por edhe ngjarja aktuale...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ngjarja aktuale ka kaluar në bulizëm. Të gjithë janë pothuajse të një grupimi moshor dhe nuk e dimë se si dhe çfarë ka ndodhur, ka qenë një terr informativ, ndaj për këtë arsye, zonja kryetare, mendoj se duhen thirrur të dy ministrat.

Milva Ekonomi – Jam shumë dakord me Norën, por do të thosha se para se të vendosim për këtë thirrje, a bëjmë një pyetje te Ministria e Brendshme, në qoftë se është informacion i klasifikuar apo deklasifikuar dhe pastaj vendosim për dëgjuesën?

Nora Malaj – E di pse u nisa nga kjo? Isha shumë dakord me idenë tuaj, por janë disa njësi, të cilat merren me informacionin për standardin e sigurisë së fëmijëve dhe për ndihmën që do t'u jepej, dhe atyre u ishte refuzuar dhënia e informacionit, që është detyrim ligjor. Ndoshta është e nevojshme që të bëjmë kërkesën dhe pastaj t'i thërrasim për situatën.

Albana Vokshi – I morëm sugjerimet tuaja, nëse ju jeni dakord, me Milvën, Fidelin dhe Kejdin, mbas mbledhjes të bëjmë një kalendar. Ne duhet të lidhemi edhe me pedagogët e asamblesë, të kemi një lloj gatishmërie nga ana tjetër dhe, po qe, e vendosim ne të tre duke pasur edhe aprovimin tuaj se çfarë do të vendoset për nesër, për pasnesër dhe për ditët e ardhshme në vazhdim, i kemi propozimet tuaja. Nëse jeni dakord, t’jua dërgojmë edhe me shkrim për të mos humbur më kohë.

Milva Ekonomi – Do të doja të shtoja edhe një gjë tjetër: ju e dini që kemi një Kod të ri të Sjelljes. Unë dhe kryetarja patëm shqetësimin që ta bënim dëgjesën konform këtij kodi. Kryetarja ka pyetur edhe në shërbimet përkatëse të parlamentit dhe kjo gjë është konfirmuar. Kështu që edhe nga ana etike e Kodit të Sjelljes jemi të organizuar ta bëjmë dëgjesën siç duhet.

Albana Vokshi – Kam pyetur, dhe për sa u përket studentëve dhe pedagogëve, mjafton të jetë një listë e dakordësuar që më pas të mos kemi probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lista do të dakordësohet këtu në komision.

Për sa u përket OJF-ve, shoqërisë civile apo lobimeve, ato domosdoshmërisht duhet të kalojnë nga procesi i regjistrimit në Kuvend. Studentët, pedagogët apo pjesa tjetër nuk kanë nevojë të regjistrohen, sepse nuk regjistrohen dot 140 mijë veta, por do të jetë një listë që ne do ta dakordësojmë, pasi gjithsecili ta ketë sjellë atë dhe të mos kemi probleme kur të kemi dëgjesat.

Milva Ekonomi – Do të biem dakord për një numër maksimal?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Edhe unë bie dakord plotësisht në parim, por që të jemi në koherencë të plotë me Kodin e Etikës, ata përfaqësues studentësh e pedagogësh që do të vijnë, nuk duhet ta kthejnë këtë komision të nderuar në arenë për të bërë politikë, por ta kenë të qartë që në fillim kohën e limituar.

Albana Vokshi – 5 deri në 7 minuta për secilin, besoj se do të jetë kohë e mjaftueshme.

Së dyti, ata kanë thënë larg nga politika dhe nuk besoj se do të vijnë për ta bërë këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Gjatë takimeve të ndryshme, kemi konstatuar se e kalojnë etikën e ndërhyrjes vend e pavend...

Albana Vokshi – Ismet, unë mendoj se studentët kanë qenë të shkëlqyer në mënyrën se si kanë protestuar, madje na kanë tejkaluar edhe ne si politikanë: pa dhunë, pa eksese, pa

politikë, ndaj mendoj të mos kemi asnjë merak të tillë, se këtu do të na shprehin vetëm shqetësimet që kanë ngritur.

Albana Vokshi – Kejdi, fjala për ju.

Kejdi Mehmetaj – Kisha dy çështje, një që është teknike: a është rënë dakord në Konferencën e Kryetarëve që të diskutojmë në komision edhe amendimet për buxhetin?

Albana Vokshi – E kam bërë kërkesë në Konferencën e Kryetarëve që të kalojë amendimi juaj për buxhetin e vitit 2019.

Kejdi Mehmetaj – Kemi marrë dakordësi për këtë?

Albana Vokshi – Mendoj se u dha dakordësia dhe, meqenëse nuk e pashë në kalendarin 3-javor, komunikova me Mozën dhe më tha që do të jetë. Ky është kalendari për javët në vijim dhe jo i këtyre që kaluan. Kur të na vijë si kalendar, do ta planifikojmë edhe atë.

Kejdi Mehmetaj – Doja të shtoja se, meqenëse amendimet që kemi bërë prekin konkretisht kërkesën e studentëve, le ta trajtojmë këtë gjë si më parësore me studentët e, më pas, të vazhdojmë me asamblëtë, përfaqësuesit e kështu me radhë, edhe sipas logjikës që tha Milva, jo vetëm për çështjet e amendimit, por në një prizëm më të gjerë të situatës aktuale.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Do të biem dakord sa më parë dhe do t’ju vëmë në dijeni.

Atëherë, e mbyllim këtë çështje të rendit të ditës, duke rënë dakord që kalendarin e propozuar nga Kryesia t’jua dërgojmë brenda dy orësh, mundësisht, që edhe ju të jeni në gjendje që të sillni propozimet tuaja.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 13.00

Albana Vokshi – kryetare Komisioni

Rendi i ditës

2. Seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Anduel Xhindi(zëvendësues) dhe Sadi Vorpsi(zëvendësues).

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Të ftuar:

Kandidatët për plotësimin e vendeve vakante në KDRTSH:

Besnik Mustafaj

Anila Bisha

Edmond Tullumani

Kristaq Birbo

Ilir Goci

Arian Paco

Helidon Haliti

Genc Tomço

Arben Lagreta

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Albana Vokshi - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, seancën dëgjimore me kandidaturat për plotësimin e tre vendeve vakante në Këshillin Drejtues të RTSH-së.

Fillojmë me kandidatin e parë për njërin prej pozicioneve, zotin Besnik Mustafaj, të cilit do të doja t'ia kaloja menjëherë fjalën, për të dëgjuar arsyet pse ai kandidon për këtë vend.

Besnik Mustafaj – Faleminderit të gjithëve!

Ndjehem i nderuar që ndodhem para jush sot. Kam dy arsye, për të cilat kam kandiduar për këtë vend: një arsye është personale. Të them të drejtën, unë i mbusha 60 vjeç dhe pashe që tërheqja nga jeta publike nuk është zgjedhja më e mirë e mundshme. Vjet vendosa të gjej disa angazhime, të cilat nuk janë të drejtpërdrejta në politikë, por përputhen me eksperiencat e mia. Vjet kemi themeluar Këshillin e Ambasadorëve Shqiptarë, që është një organizatë ku bëjnë pjesë ambasadorë të të gjitha krahëve politike.

Që vjet, sepse koha e paraqitjes së kandidaturës është zgjatur shumë, për arsye që ju i dini, paraqita kandidaturën për vendin e anëtarit në Këshillin Drejtues të RTSH-së.

Arsyeja e dytë është parimore. Kam vënë re se bordet, këshillat drejtues në përgjithësi në realitetin tonë janë të shpërfillura dhe nuk luajnë rolin që u jep ligji. Unë do të doja, duke hyrë për herë të parë në një bord, në një këshill të kësaj natyre, të luaja rolin tim për t'i dhënë hapësirë dhe ndikimin që ka një këshill drejtues, që ia parashikon ligji, jo më shumë e as më pak, siç është rasti i televizionit shqiptar. Po ashtu, nga pikëpamja e telespektatorit, Radiotelevizioni Shqiptar me digjitalizimin ka hyrë në një fazë shumë serioze, por unë besoj dhe kam bindjen se është larg mundësive që zotëron në sajë të digjitalizimit, qoftë me programacionin e vetë, qoftë edhe me prodhimin. Edhe në ligjin për mediat, por edhe në statusin e Radiotelevizionit Shqiptar, Këshilli Drejtues ka një rol shumë të madh ndikues për t'i përmirësuar këto gjëra. Për aq sa mund të jetë roli i një anëtari të këtij këshilli, unë shpresoj ta luaj.

Këto janë dy arsye që më kanë shtyrë dhe që ndodhem sot para jush.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Ka pyetje?

Luçiano Boçi – Zoti Mustafaj, urime!

Në fakt, qenia juaj në atë këshill, i bën nder atij këshilli. Njoh problematikën e RTSH-së, që vërtet me digjitalizimin duhet të ishte lideri i televizioneve, por nuk e ka arritur atë, sikurse ka edhe një marrëdhënie delikate midis RTSH-së dhe televizioneve lokale, njëlloj konflikti apo mosmarrëveshjeje që lidhet edhe me qëndrimin e këshillit ose mosfunksionimin e tij. Është çështja e mbartjes dhe e pagesës së tyre për një vit falas dhe rimbursimit.

A keni një mendim për zgjidhjen e këtij konflikti, është pyetja e parë, meqenëse është shumë akut si problematikë, madje ne kemi planifikuar të mbledhemi si komision për këtë çështje bashkë me AMA-n për ta diskutuar.

Pyetja tjetër ka të bëjë përsëri me pozicionin e RTSH-së, i cili, me gjithë investimet e mëdha që janë bërë realisht me digjitalizimin, sepse ka qenë strategjia e miratuar para vitit 2013 për këtë, në vitin 2015 duhet të kishte përfunduar e të tjera, RTSH-ja nuk ka arritur të ketë një rol shumë më të madh në audiencë dhe në ndikimin e saj te publiku, duke dashur me atë iniciativën e madhe të politikës për t'ia kthyer RTSH-në publikut. Pse nuk ka ndodhur një gjë e tillë, si mendoni dhe pse RTSH-ja vazhdon të jetë në ato nivele audience që ka qenë më parë, në mos gaboj 10 % e audiencës dhe nuk ka tërhequr vëmendjen e publikut me gjithë diversitetin e programeve dhe të kanaleve që ajo ka shtuar? Pra, ku çalon puna në këtë RTSH-në tonë të famshme, që merr shumë para edhe nga buxheti i shtetit, por nuk jep atë rezultat që pritet dhe kërkohet si nga politika, asnjëherë në këtë rast, ashtu edhe nga publiku? Si mendoni se do të zgjidhen në projektin tuaj si anëtar i Këshillit Drejtues?

Fadil Nasufi – Po bëj një ndërhyrje për procedurë më tepër, zonja kryetare. Që të mos hyjmë në situatën aktuale që është RTSH-ja, zoti Mustafaj është një figurë shumëdimensionale, ish – deputet, publicist i njohur, shkrimtar i njohur, në fushën e diplomacisë ka kontributet e veta, është propozim i një institucioni, pastaj në raportet që kemi ne për vendimmarrje, këto janë çështje të tjera. Kështu që të mos bëjmë pyetje të karakterit se si do ta menaxhojë. Në qoftë se ai do të zgjidhet, ta thërrasim në komision e të na thotë se si do t'i menaxhojë problemet e televizionit.

Ismet Beqiraj – Edhe unë jam dakord me kolegun, por ama figurës së nderuar, Besnik Mustafaj, dua t'ia bëj patjetër disa pyetje: së pari, cili është vizioni juaj për ta bërë RTSH-në konkurrent të fuqishëm në tregun mediatik, sepse një pjesë buxhetohet, ndërsa pjesa tjetër bëhet nga të ardhurat e vet RTSH-së?

Së dyti, sa për qind të eksperiencës, të qetësisë, të dijes, të vlerave që keni do ta injektoni me prezencën tuaj si anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, që televizioni ynë jo vetëm të jetë konkurrenës, por i dashur për të gjithë dhe të mos hidhet baltë vend e pavend si deri më tani?

Albana Vokshi -Edhe një pyetje dhe besoj që janë mjaftueshëm, se nuk kemi se për çfarë ta pyesim zotin Mustafaj. Ai shqyr që po shkon atje!

Shezai Rrokaj - Është një pikë, me të cilën bashkohem me Fadilin, Besnik Mustafaj është një aset i shoqërisë shqiptare edhe në politikë, edhe në kulturë dhe unë them që një figurë si Besnik Mustafaj në atë këshill, nuk ka nevojë për pyetje. Na bën mirë, i bën mirë televizionit dhe jam i sigurt që *grintën* që ai ka, ka pasur dhe e ka dëshmuar edhe në shoqëri, do ta shtjellojë edhe më tej në ndihmë të RTSH-së, sepse, edhe t'i kërkojmë llogari për çfarë është televizioni shqiptar, kur ai nuk ka qenë...

Ne shpresojmë që me praninë e tij, duke marrë parasysh edhe rolin që ka një anëtar, unë kam qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit dhe e di çfarë kompetencash ka... Do t'u kërkoja kolegëve t'ia kursejmë pyetjet dhe të jemi të nderuar me praninë e tij. Ne jemi në një ditë të mirë sot për Besnik Mustafajn, ndihemi mirë të gjithë, të paktën, shpresoj. Unë po, sepse e njoh që kur kemi qenë në shkollë bashkë. Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Vali, keni pyetje?

Valentina Duka – Jo, nuk kam pyetje. Bashkohem me Shezaiun dhe i bëj thirrje kolegëve të tërheqin pyetjet.

I mirëkuptoj për pyetjet, sepse të gjithë duan që RTSH-ja të jetë mirë, pasi mbahet me paratë publike, por të gjithëve na bën nder që Besnik Mustafajn, mikun tonë, ta kemi në bord. Pasi ai të fillojë punë në bord, nëse ne do të kemi nderin ta votojmë, mund ta thërrasim dhe t'i bëjmë pyetje specifike si menaxhohet më mirë një institucion kaq i rëndësishëm. Tani mendoj ta lëmë Besnikun.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, nuk ka problem.

Luçiano Boçi – Ju lutem, të ndërhyj pak, sepse duket si frustrim që po i bëjmë kandidatit.

Albana Vokshi – Jo.

Luçiano Boçi – Një minutë, të sqaroj edhe pozicionin tim tani, sepse e kam shumë seriozisht.

Albana Vokshi – Është i mirëkuptueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi –Nuk kam qejf të bëj pyetje, sepse do të zbulohet cili është Besniku, të cilin të gjithë e njohin, disa shumë më shumë sesa unë. Unë e njoh në pjesën profesionale, letrare, disa në politikë. Problemi është se duke i hequr mundësinë e përgjigjes kandidatit të

parë, moralisht jemi në të njëjtin pozicion me të gjithë kandidatët. Unë jam dakord, por duhet ta zbatojmë si normë diçka të tillë.

Albana Vokshi – Nuk ka problem.

Luçiano Boçi – Apo jo, Besnik?

Albana Vokshi – Ju lutem, ju dëgjova!

Unë nuk besoj të ketë problem edhe nëse e pyesim zotin Mustafaj, edhe mund të përgjigjet në respekt të kolegëve deputetë, nëse ka ndonjë përgjigje. Secili e ka respektuar, ka bërë dy pyetje për vizionin që ka ai për Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit. Jam e sigurt që, edhe në bisedat që kam pasur me zotin Mustafaj, ai është në dijeni të problematikës. Ka raste shumë të thella, ka raste edhe të problematikës të përditshme, ndaj, nëse zoti Mustafaj e konsideron, mund të japë një përgjigje, që të vazhdojmë më pas.

Besnik Mustafaj – Patjetër.

Unë ju falënderoj!

Problemi që ngre Luçiano për marrëdhëniet e Radiotelevizionit Shqiptar me televizionet lokale është pasojë e moszbatimit të angazhimeve nga ana e Radiotelevizionit Shqiptar, sepse ekziston kuadri ligjor dhe mundësitë konkrete që Radiotelevizioni në Tiranë t'i plotësojë këto kërkesa dhe të sigurojë një funksionim normal.

Unë kam pasur rastin ta dëgjoj këtë gjë shumë konkretisht nga drejtori i njërit prej radiotelevizioneve lokale, si një problem që atyre ua vështirëson ekzistencën.

Besoj se digjitalizimi dha një mundësi shumë të madhe që televizionet lokale, si i Korçës, i Gjirokastrës e të tjera, të fitojnë një rol të madh kulturor, por edhe informativ në rajonet ku ekzistojnë dhe janë mundësitë. Me aq sa ka në dorë një anëtar i Këshillit Drejtues, me aq sa ka në dorë edhe Këshilli Drejtues, si një instancë kontrolluese dhe nxitëse për zbatimin e angazhimeve nga ekzekutivi i Radiotelevizionit Shqiptar, besoj se do të jem aktiv dhe dinamik. Unë nuk mund të zotohem para jush që sa të shkoj unë atje, Radiotelevizioni Shqiptar do të fillojë të përmbajë angazhimet e veta ndaj televizioneve bija, po i quaj televizionet lokale, por gjithsesi, ngritja e problemit në bord është një mënyrë për të nxitur ekzekutivin të kryejë angazhimet e veta.

Pyetja e dytë e Luçianos është pak a shumë e njëjtë me pyetjen tjetër. Unë do të thosha se e kam lexuar me vëmendje programin ose projektin me të cilin zoti Gëllçi ka fituar vendin e drejtorit të Përgjithshëm. Është një projekt absolutisht serioz dhe i gjerë. Nëse nga ky projekt, i hartuar nga vetë personi që është sot në krye të Radiotelevizionit Shqiptar, do të zbatohet qoftë edhe gjysma, ju siguroj që Radiotelevizioni Shqiptar do të ishte realisht konkurrent, madje edhe lokomotivë në tregun mediatik shqiptar, por konstatoj që nuk është zbatuar. Kjo

do të thotë se ka qenë një nga shumë programet që bëhen në skenën publike shqiptare dhe më pas nuk vihen në jetë.

A do të kem unë mundësi të ndikoj që ky program individual, e theksoj, dhe absolutisht serioz, sërish e theksoj, i zotit Gëllçi, të vihet në jetë? Nuk e di sa mundësi do të kem, për Zotin, por unë do të them fjalën time. Nuk është hera e parë në jetën time që do të gjendem pjesë e një ekipi, ku nuk mbahen premtimet, por do të përpiqem të ruaj fytyrën time, ndaj e përmenda 60-vjetorin, që nuk kam më kohë ta pastroj nëse e njollos tani.

Albana Vokshi – Faleminderit shumë, zoti Mustafaj!

Nuk besoj se ka pyetje apo konstatim tjetër.

Edhe një herë, dua t’ju vë në dijeni që zoti Mustafaj kandidon për postin që ka pasur Artan Peqini, i cili është pjesë e opozitës në Këshillin Drejtues.

Musa, ke pyetje para se të ikë Besniku?

Musa Ulqini – Jo.

Albana Vokshi – Atëherë, zoti Mustafaj, ju falënderojmë shumë që erdhët dhe ju urojmë suksese!

Besnik Mustafaj – Faleminderit!

Edhe unë ju uroj shumë suksese!

Albana Vokshi –Zoti Sadik Spahia kishte ardhur në Kryesinë e Kuvendit, por i ka dalë një problem personal dhe është larguar. Pra, nuk do të jetë këtu për dëgjuesë.

Zoti Avni Neza nuk ka ardhur.

Për kandidaturën e zotit Peqini...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Sapo e thashë që iku për arsye personale.

Faleminderit, znj. Anila Bisha!

Mendoj se të gjithë kolegët deputetë duan të dinë arsyet pse ju kandiduat për një nga pozicionet e Këshillit Drejtues të RTSH-së, pikërisht për postin që mbahej nga zoti Artan Peqini.

Po, jua kaloj fjalën menjëherë.

Faleminderit!

Anila Bisha – Faleminderit!

Unë jam Anila Bisha. Me profesion jam aktore në Teatrin Kombëtar prej 27 vjetësh.

Duke qenë se kam qenë afër institucionit të Televizionit Shqiptar jo vetëm nga profesioni, por edhe kam punuar 3 vjet si moderatore e një emisioni kulturor, kam arritur të shikoj edhe nga afër se si funksionon Televizioni dhe ndoshta edhe problematikat në atë

institucion. Duke qenë se jam grua, mendoj se institucioni ka të ardhura të bollshme për të qenë më tepër gjithëpërfshirës për sa u përket disa fushave. Për shembull, mendoj se duhet të ketë sa më tepër emisione që prekin temat dhe problemet e grave sot, sepse mungojnë dhe është një institucion që ka mundësi të prodhojë jo vetëm filma, por edhe seriale. Kjo do të ndihmonte mjaft për të prekur temat që ne na shqetësojnë dhe duke larguar, në njëfarë mënyre, edhe femrat nga telenovelat e famshme turke, që, për mendimin tim, janë bërë një problem i madh. Mendoj se Televizioni Shqiptar ka jo vetëm mundësi, por ndoshta edhe detyrim që të ketë më tepër prodhime shqiptare sesa ka. Mendoj se do të jap kontributin tim në këtë drejtim.

Gjithashtu, mendoj se do të kontribuoj edhe për sa i përket angazhimit të të rinjve në projekte, sepse nuk shikoj përfshirje të madhe të tyre për sa u përket projekteve në Televizionin Shqiptar.

Albana Vokshi – Keni pyetje për Anilën, ju lutem?

Nuk ka.

Anila, faleminderit që erdhët!

Anila Bisha – Shumë faleminderit edhe ju!

Albana Vokshi – Të urojmë suksese!

Ju lutem, vazhdojmë me grupin tjetër, që kandidojnë për vakancën që mbante zoti Pashk Përvathi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka qenë vakanca për pozicione të caktuara. Kanë qenë të hapur për këtë pozicion dhe me kode të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, kanë aplikuar për këtë pozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, vazhdojmë me kandidaturat një nga një.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Kandidatura e parë është zoti Edmond Tullumani, i diplomuar për muzikë, kulturë dhe juridik, propozuar nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë.

Ju lutem, shumë shkurt, zoti Tullumani, për arsyt pse ju vendosët të kandidoni për këtë pozicion.

Edmond Tullumani – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë, kandidimi im për Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar konsiston në përvojën time personale, duke qenë një bashkëpunëtor prej shumë vjetësh me

Radiotelevizionin, të cilin e njoh në brendësi, si nga ana teknike, edhe në programet e tij. Mendoj se stazhi im në gjithë këta vjet në koncerte të ndryshme, që besoj se njihen, do të jetë i vlefshëm për të kontribuar në programet dhe në cilësinë e Radiotelevizionit. Dëshira ime është të kontribuoj në këtë institucion të rëndësishëm publik.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, zoti Romeo!

Romeo Gurakuqi – Faleminderit!

Për sa i përket ekipit drejtues i Radiotelevizionit dhe Orkestrës Simfonike, cilat janë vuajtjet, pak a shumë, të strukturës muzikore brenda Radiotelevizionit? E kam fjalën për gjendjen e financimit të orkestrës simfonike të Radiotelevizionit, problematikat që ndesh orkestra dhe si e konceptoni ju që orkestra aq e rëndësishme për Shqipërinë të jetë në pozicionin e duhur, që nderon jo vetëm institucionin, por edhe nivelin dhe cilësinë e muzikantëve, të cilët në vetvete përfaqësojnë njerëz shumë të shkolluar dhe për të shkuar deri atje kanë harxhuar një pjesë të rëndësishme të jetës së tyre profesionale.

Faleminderit!

Edmond Tullumani – Pyetja juaj është shumë e drejtë dhe dua të theksoj se prania e një orkestre, siç është orkestra e RTSH-së, është një aset shumë i çmuar. Për mendimin tim, si menaxher dhe producent i koncerteve, e vetmja gjë që kërkon më shumë veprimtari dhe cilësi është programacioni i kësaj orkestre, i cili duhet të jetë sa më efikas. Pra, është një aset i çmuar, me studiot dhe me vlerat që ka RTSH-ja. Unë kam qenë shumë i ri kur kemi incizuar muzikë të ndryshme dhe vepra të ndryshme shqiptare, dhe duhet të jetë me eficiencë të lartë për të pasur programe shumë cilësore për sa i përket muzikës simfonike. Njëkohësisht edhe shfaqjet e saj duhet të jenë të programuara, me publik të veçantë dhe duhet të jetë shumë efikase si për festat, ashtu edhe për raste të ndryshme. Pra, duke ofruar programe të një cilësie të lartë, sepse aty nuk mungojnë elementet. Në lidhje me pjesën sofistike, unë mendoj se kjo orkestër do ta ngrejë shumë vlerën dhe do të jetë shumë e frekuentuar. Pra, është si një Vjenë në Tiranë.

Albana Vokshi - Nëse nuk ka pyetje të tjera, e falënderoj zotin Tullumani.

Vazhdojmë me zotin Kristaq Birbo.

Zoti Birbo, ju si ushtarak dhe si drejtor Ekzekutiv i Këshillit Atlantik të Shqipërisë, nga i cili jeni propozuar, ju lutem, na thoni disa nga arsyet pse vendosët të kandidoni për Këshillin Drejtues të RTSH-së?

Kristaq Birbo - Arsyeja e parë është se më propozuan.

Së dyti, vendi ishte vakant dhe mendova pse të mos e synoj.

Së treti, unë e njoh shumë mirë administratën, sepse kam qenë edhe këshilltar i presidentit Moisiu dhe i njoh marrëdhëniet me jashtë. Kështu, këto janë arsyet.

Albana Vokshi - A keni ndonjë pyetje kolegë deputetë?

Milva Ekonomi - Kam një pyetje: a jeni njohur me planin strategjik të zhvillimit të RTSH-së? A e keni parë propozimin e bërë nga zoti Gëllçi, se si do ta drejtonte Televizionin Shqiptar?

Kristaq Birbo - Unë i njoh çështjet në vija të përgjithshme, si dhe ligjin përkatës, por, natyrisht, në qoftë se do të angazhohem në këtë punë, do të studioj më në thellësi ligjet, rregulloret, planet dhe programet afatmesme, afatshkurtra e të tjerë.

Albana Vokshi - Nëse nuk ka pyetje të tjera, unë e falënderoj zotin Birbo.

Vazhdojmë me zotin Ilir Goci.

Atëherë, zoti Ilir Goci është ekonomist dhe është kandidaturë e propozuar nga Promocion 3D. Zoti Goci kandidon për pozicionin që mbante zoti Pashk Përvathi dhe i takon opozitës.

Ju lutem, zoti Goci, mund të na thoni disa nga arsyet që ju shtynë për të kandiduar për pozicionin e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së?

Ilir Goci - Unë jam ekonomist në profesion dhe të vetmes gjë që mund t'i kushtoja vëmendje është kompetenca e Këshillit Mbikëqyrës të RTSH-së. Falë përvojës mendoj se mund ta kryej mirë atë detyrë, përpos asaj që kam punuar edhe në medie, por baza ime është profesioni i ekonomistit.

Albana Vokshi - Faleminderit!

A keni pyetje për kandidaturën e zoti Goci.

Mirela Kumbaro - Zoti Goci, ju thatë se keni punuar në medie. Për çfarë lloj eksperience e keni fjalën, ju lutem?

Ilir Goci - Si të gjitha televizionet e pavarura, edhe televizioni ku unë kam punuar ka qenë i pavarur. Televizioni ANT1 është themeluar në vitin 1999 dhe unë kam qenë drejtori i parë, që e kam menaxhuar për disa vjet.

Albana Vokshi – Faleminderit, shumë zoti Goci!

Nuk ka pyetje të tjera.

Ilir Goci - Punë të mbarë të gjithëve!

Albana Vokshi - Faleminderit dhe suksese!

Atëherë, vazhdojmë me zotin Arian Paco.

Zoti Arian Paço është violinist dhe pedagog, i cili është propozuar nga shoqata “Qendra e artit konteporan”. Zoti Paco kandidon për një nga vakancat, që i takon pozitës që mbante Pashk Përvathi.

Ju lutem, disa prej arsyeve që ju shtynë juve për të kandiduar për postin e anëtarit të Këshillit Drejtues.

Arian Paço – Kam një eksperiencë pune 38-vjeçare. Besoj se sektorin e muzikës e njoh mirë dhe në veçanti sektorin e orkestrës, pasi kam punuar për 8 vjet në orkestrën e Teatrit të Operës, prandaj mendoj se e njoh problematikën. Kjo është edhe arsyeja e konkurrimit tim në këtë post, për t’u dhënë një shtysë problemeve të artit, më specifikisht problemit të orkestrave dhe të Radiotelevizionit. Unë mendoj se mund të jap një kontribut të rëndësishëm në këtë punë.

Albana Vokshi – Faleminderit!

A keni ndonjë pyetje? Nuk keni pyetje.

Faleminderit që erdhët!

Me zotin Paço, mbyllen kandidaturat e dy pozicioneve që i takojnë opozitës.

Tani kemi kandidaturën e tretë, që është zoti Elidon Haliti, i cili rikandidon për këtë pozicion. Ai ka mbaruar Fakultetin e Arteve Figurative dhe është propozuar nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

Zoti Haliti, ju e keni mbajtur për disa vite këtë pozicion. Na thoni diçka në lidhje me problematikat që keni trajtuar dhe arsyet përse rikandidoni në të njëjtin pozicion si anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Ju lutem, shumë shkurt.

Elidon Haliti – Shkaku që unë rikandidoj është çështje shorti, sepse më qëlloi shorti i tri vjetëve. Gjatë këtyre viteve puna ka qenë shumë intensive për arsye të digjitalizimit, i cili ndodhi atë ditë kur u bë mbledhja e parë. Problematikë dihet që është çështja e digjitalizimit, për arsye se të gjithë specialistët e RTSH-së nuk ishin të familjarizuar me digjitalizimin, ndërkohë të gjithë ata që kanë ardhur nuk janë aq të familjarizuar me RTSH-në.

Platforma është botuar dhe është një proces që mendoj që duhet shtrirë në kohë. Ne si Këshill kemi bërë vërtet shumë punë dhe pjesëmarrja ime ka qenë rreth 99%. Ne kemi bërë 30 e ca mbledhje në vit, për shkak të zgjedhjes së drejtorit të Përgjithshëm dhe të proceseve të tjera që kanë ndodhur, ndërkohë që ligji thotë deri në 6 mbledhje në vit.

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Haliti!

A ka pyetje?

Luçiano Boçi – Ju uroj suksese, meqenëse keni bërë maratonë mbledhjesh dhe keni tejkaluar planin, siç thatë. Unë dua të di: a kanë pasur efektivitet këto mbledhje, jo në raport të produktit të mbledhjes për zgjedhjen e drejtorit, për digjitalizimin dhe në raport me televizionet lokale, por në atë çfarë duhet të jetë RTSH-ja?

Ju kam dëgjuar edhe para 3 vjetësh, sepse kam qenë pjesë e komisionit dhe ajo që është kërkuar me forcë nga komisioni ka qenë vendosja e RTSH-së në një pozitë konkurruese me televizionet e tjera. Ju, si Këshill, me mbledhjet tuaja, a mendoni që e keni arritur këtë gjë? Pra, a është rritur audienca, cilësia dhe ato pikat e performacës së një televizioni, që vërtet mund të quhet publik? Ky është shqetësimi i komisionit, pavarësisht se ne i themi me terma të tjerë, sepse ndryshe e thotë mazhoranca dhe ndryshe opozita, por në thelb shqetësimi ynë është nëse ky televizion është vërtet publik në sajë të këtyre mbledhjeve.

Albana Vokshi – Po, zoti Haliti.

Elidon Haliti – Televizioni publik ka për detyrë të informojë publikun dhe jo të jetë konkurrent ndaj televizioneve private, sepse ka një sensibilizim tjetër, atë të informimit. Pra, atë që quhet “*rush time*” nuk mund ta godasim, për arsye se tematikat e televizionit publik duhet të drejtojnë televizionet private. Pra pyetja është: a janë televizionet private të ndikuar nga televizioni publik? Përgjigjja ime është jo.

RTSH-ja ka ngritje të mëdha dhe kjo është bërë nga një punë shumë intensive, por ka ndihmuar shumë edhe digjitalizimi, sepse e shikon rreth 85% e popullsisë dhe synimi është që të kapë 90% të territorit dhe më shumë. Televizioni publik shikohet dhe për këtë arsye janë hapur më shumë se 10 kanale. Pra, unë mendoj se kemi një pozicion të konsiderueshëm në medie.

Albana Vokshi – Nuk ka pyetje të tjera.

Ju falënderoj dhe ju uroj suksese.

Atëherë, zoti Genc Tomço është inxhinier elektrik, është propozuar nga Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit.

Zoti Tomço, cila është arsyeja që kandiduat për postin e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së?

Genc Tomço- Dua të them, se arsyeja e parë është se unë kam punuar në Radiotelevizionin Shqiptar për 40 vjet. Po ta përmbledhim, e kam bërë Radiotelevizionin, sidomos Televizionin Shqiptar. Kam punuar dhe mbuluar në të gjithë sektorët. Me njohuritë që kam mendoj se mund të vazhdoj të kontribuoj. Më pas kam punuar në Arkivin Qendror, në Agjencinë Telegrafike kam punuar 3 vjet, ku bëra digjitalizimin e kësaj Agjencie.

Arsye tjetër është se në Këshillin Drejtues të RTSH-së me sa pashë nuk kishte inxhinier që të plotësonte “buqetën” e këtij Këshilli. Pra, edhe kjo ishte një arsye tjetër që më shtyu të aplikoja.

Albana Vokshi - Faleminderit shumë!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ju falënderoj për praninë dhe për prezantimin tuaj!

Genc Tomço- Ju falënderoj për ftesën!

Albana Vokshi - Është edhe zoti Arben Lagreta. Është i fundit apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Arben Lagreta është gazetar, ka mbaruar Fakultetin për Gjuhë dhe Letërsi, është propozuar nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

Zoti Lagreta, shumë shkurt arsyet pse ju vendosët të kandidonit për pozicionin e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Arben Lagreta – Faleminderit!

Unë njoftimin e kam parë rastësisht. Vij nga gazetaria profesioniste dhe siç thatë edhe ju jam propozuar nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, nga zoti Çipa.

Profilizimin tim e kam për gazetari investigative. Jam kualifikuar, përveç të tjerave, 3 herë nga Këshilli i Europës në fushën e të drejtave të njeriut, ndër të cilat më e rëndësishmja është brezi i parë i shkollës së studimeve politike 2007. Duke pasur parasysh se edhe me kaq eksperiencë në marrëdhëniet me jashtë, pasi mbuloj edhe marrëdhëniet me jashtë për rajonin e Veriut në Unionin e Gazetarëve Shqiptarë, si edhe nga eksperiencia që kam pasur, ndonëse për një periudhë jo të gjatë që kam jetuar në Francë, këshillat drejtuese, pjesën dërmuese për të mos thënë të gjithën, të paktën gjysmën i kanë gazetarët, vendosa të jap kontributin tim në fushën time, por duke qenë një “gardian” i mirë i interesave të taksapaguesve në raport me ato fonde që shkojnë për të mbajtur një radiotelevizion publik.

Përveç kësaj do të thosha diçka, jo për vete, të kemi parasysh një gjë që veting ka nevojë edhe media. Këtë gjë e kam thënë edhe në shtypin e shkruar. Ka dy vjet që bërtas për këtë punë. Për veting ka nevojë edhe në medie, sepse po shikojmë gjithfarë gazetarësh të vetëquajtur të profileve të ndryshme që janë aty, jo për të thënë atë që duhet, por për të varrmihur të vërtetat. Po flas për gazetarinë investigative. Kam ardhur në këtë komision të nderuar t’i kërkoj votën gjithsecilit prej jush pa përjashtim, sepse jam i bindur se në një këshill drejtues, siç është ai për RTSH-në, për të mos u zgjatur, kam përse ta jap kontributin tim. Jam i hapur për pyetje. Të më falni se është hera e parë që jam këtu!

Albana Vokshi - A keni pyetje? Nuk ka.

Faleminderit shumë që erdhët!

Faleminderit për prezantimin!

Ju urojmë suksese në detyrën tuaj!

Zonja Ormira Lulanaj, piktoe, Akademia e Arteve të Bukura, që është propozuar nga Rrjeti i Gazetarëve Shqiptarë të Politikës nuk është paraqitur. Automatikisht bie si kandidaturë.

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 13.30

Albana Vokshi – kryetare Komisioni

Rendi i ditës

3. Votimi dhe miratimi i 3 kandidaturave për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Anduel Xhindi(zëvendësues) dhe Sadi Vorpsi(zëvendësues).

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Albana Vokshi - Si procedurë do të merret vendimi për secilin nga pozicionet, bëhet përjashtimi i dy prej kandidaturave të paraqitura, të cilin e bën grupi parlamentar për pozicionet e opozitës, 2 për secilën kandidaturë i përjashtoni juve, deputetët e PS-së, dhe 2 shkojnë për votim apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A e sqaroni pak të lutem?

Sonila Kadare - Është procedura përjashtuese që fillon nga maxhoranca, një nga maxhoranca, një nga opozita dhe emri që mbetet është automatikisht emri i përzgjedhur nga komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Edhe një herë, fillimisht kualifikohen dy prej tyre?

Luçiano Boçi- Kam një sqarim të vogël. Mund ta zbatojmë këtë procedurë siç e ka ligji, por mund të ketë edhe marrëveshje, siç e kemi bërë, apo jo? Hajdeni të zgjedhim mënyrën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të ishte bërë më parë kjo punë.

Milva Ekonomi - Do ta vendosim sot?

Albana Vokshi - A doni ta bëjmë sot votimin, që t'i përjashtojmë një nga një kandidaturat?

Dikush ishte, tha po iki, dikush tjetër nuk ka ardhur, duke mos respektuar komisionin.

Doni që të mblidhemi dhe të përcaktojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Kush do ta marrë fjalën nga maxhoranca, zoti Ulqini apo zonja Ekonomi?

Milva Ekonomi – Unë bie dakord që ne të vendosim kështu: për ata që nuk erdhën në dëgjese dhe ata që nuk u paraqitën, duke ardhur dhe duke mos u paraqitur, të jenë të përjashtuar automatikisht. Domethënë, ne kemi disa emra që nuk u paraqitën, si, për shembull, Ormira Lulanaj, Sadik Spahija dhe Avni Nezaj.

Këta janë të përjashtuar automatikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flas për një person që i takon maxhorancës.

Tani të vazhdojmë me propozimet që kemi ne për përjashtim nga lista e Partisë Demokratike?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po.

Milva Ekonomi – Ne mendojmë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk ka ardhur.

Milva Ekonomi – Nuk ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E votojmë. Të fillojmë me kandidaturën e Artan Peqinit? Ne mendojmë se duhet përjashtuar Anila Bisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Atëherë, mbetet vetëm zoti Mustafaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po.

Albana Vokshi – Atëherë, janë të tria kandidaturat të përjashtuara.

Milva Ekonomi – I përjashtuam të tria kandidaturat që nuk u paraqitën.

Albana Vokshi – Po, ju përjashtuat edhe Anilën. Kështu që mbetet vetëm zoti Besnik Mustafaj te kandidatura. A jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Opozita është dakord.

Milva Ekonomi – Të vazhdojmë ne?

Albana Vokshi – Po.

Milva Ekonomi – Atëherë, nga grupi i dytë, ku keni zotin Pashk Përvathi, ne përjashtojmë zotin Kristaq Birbo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Biem dakord?

Milva Ekonomi – Duhet të përjashtoni ju tani një prej tyre.

Albana Vokshi – Atëherë, përveç Ormirës, e cila nuk u paraqit, ne përjashtojmë zotin Genc Tomço, inxhinier elektrik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë më thatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdoni, atëherë.

Milva Ekonomi – Vazhdojmë të përjashtojmë zotin Ilir Goci, ekonomist, propozuar nga “Promotion 3D”.

Albana Vokshi – Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Përjashtojmë zotin Arian Paço...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu pra, thatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Në rregull.

Vazhdoni, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Atëherë, ne, si opozitë, përjashtojmë kandidaturën e zotit Arian Paço.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Edhe një juve.

Milva Ekonomi – Përjashtojmë zotin Ilir Goci.

Albana Vokshi – Atëherë, mbetet vetëm kandidatura e zotit Edmond Tullumani.

Biem dakord? Opozita, dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, për kandidaturën e zotit Helidon Haliti, ne përjashtojmë zotin Genc Tomço.

Biem dakord, zonja Ekonomi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ne përjashtojmë zotin Arben Lagreta.

Albana Vokshi – Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, mbetet vetëm zoti Helidon Haliti. Pra, janë tri kandidaturat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Biem dakord për Helidon Halitin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të gjithë jemi dakord. Atëherë, këto tri kandidatura të pasqyrohen në vendim dhe vendimi kalon nesër. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E mbyllim për sot?

Sonila Kadare – Vendimi ka kaluar, vetëm do të zbardhet.

Albana Vokshi – A do ta zbardhni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A t’ju bëjmë edhe një përmbledhje, që të mos kemi problem, se e hapëm herën e kaluar...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Herën e kaluar hapëm tri vakanca. Tani, për çdo vakancë duhet të vijmë katër kandidatura. Metoda e përjashtimit, që e kuptuam këtu sot, është: përjashtojmë një ne, përjashton një opozita.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përjashtojmë një ne, përjashton një opozita dhe ai që mbetet, votohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Që ta kemi parasysh te kandidaturat që do të vijmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë që na përsëriti zonja Mehmetaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Iku, por e kuptuam tani.

(Diskutime në sallë.)

Nga ajo listë, do të përjashtojmë edhe ne një.

Gazmend Bici – Jo, nuk kërkohet votimi juaj. Pra, është përkatësia, dy i kishte opozita, një maxhoranca. Pra, ata të opozitës duhet të mbështeten nga opozita, ata të maxhorancës, nga maxhoranca.

(Drejtimi i mbledhjes i kalon zonjës Ekonomi.)

Milva Ekonomi – Zoti Gurakuqi, keni gjë për të thënë?

Të nderuar kolegë, a biem dakord që nesër të mbledhemi në orën 10:00?

(Deputetja Mehmetaj flet pa mikrofon.)

Kë të duan, por duhet të biem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të kemi pedagogët nesër.

Kejdi Mehmetaj – Po.

Milva Ekonomi – Në rregull, nesër në orën 10:00 kemi dëgjuesën me pedagogët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të biem dakord për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm këtë nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani do të përpilojmë listën e pedagogëve, duke ia çuar...

(Diskutime në sallë.)

Domethënë, nesër do të zhvillojmë dëgjesën me pedagogët, ndërsa me studentët më
mbrapa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

(Deputetja Mehmetaj ndërhyr pa mikrofon.)

T'i shkruaj unë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë, Fideli dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albanës do t'i sjellim një mesazh për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, dëgjesën me studentët ta kryejmë të mërkurën pasdite.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit! Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA